

Jetëshkrim i shkurtër i ish Ambasadorit

Lindur në Tiranë, në vitin 1958, mbaruar studimet e larta në Fakultetin e Histori-Filologjisë në Tiranë, specializuar në gjuhë dhe letërsi shqipe dhe angleze, futet në diplomacinë shqiptare në vitin 1997. Për një periudhë 5 vjeçare, kryen detyrën e Zëdhënësit dhe Drejtorit të Drejtorisë së Shtypit dhe Informacionit në Ministrinë e Punëve të Jashtme (MPJ), më pas, merr detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Analizë-Prognozës në MPJ, atë të Këshilltarit dhe Zëdhënësit të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë dhe, në vitin 2003, detyrën e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të RSH në Republikën e Polonisë, Ukrainë, Estoni, Letoni dhe Lituani. Në vitin 2008, emërohet Drejtor i Drejtorisë së Evropës Juglindore dhe, në vitin 2009, Ambasador i Shqipërisë në Federatën Ruse, Bjellorusi, Kazakistan dhe Uzbekistan. Mbas mbarimit të këtij shërbimi, caktohet, në vitin 2014, me detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Marrëdhënieve Dypalëshe dhe, me pas, në atë të Drejtorit të Përgjithshëm për Çështje Politike dhe Strategjike në MPJ shqiptare. Në vitin 2015 e deri në fund të karrierës së tij aktive diplomatike në MEPJ shqiptare, kryen detyrën e Drejtorit të Drejtorisë për Organizatat Ndërkombëtare dhe atë të Raportimeve dhe të Drejtave të Njeriut në MEPJ shqiptare. Veprimtaria e tij e suksesshme diplomatike është nderuar me Medaljen e Mirënjohjes nga Presidenti i RSH dhe me Urdhërin e Kalorësit nga Presidenti i Republikës së Polonisë.

